

"INTER DISTRIBUTION SERVICES" SH.P.K.
Regjistruar me Vendim Gjykatë nr. 37944, dt. 05.04.2007.
NUIS: K71612801P.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, Shqipëri.

VENDIM

**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"INTER DISTRIBUTION SERVICES" SH.P.K.**

Nr. 21, Datë 18.04.2024.

Sot, më datë 18.04.2024, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "INTER DISTRIBUTION SERVICES" sh.p.k., me adresë në: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Tiranë, e regjistruar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 37944, më datë 05.04.2007, me NUIS K71612801P, e përbërë nga zotëruesit e 100% të kuotave të kapitalit:

1. **Shoqëria me Pëgjegjësi të Kufizuar "Investment Joti – Infosoft Group"**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, më datë 25.02.2009, me NUIS K91425022E, me Administrator Znj. Blerta Elezaj, e cila zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.
2. **Z. Plarent Kristo**, i cili zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.
3. **Z. Roland Joti**, i cili zotëron 1/3 e kapitalit të Shoqërisë.

Duke qenë se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve plotëson kuorumin e caktuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Asambleja ka për rend dite:

- Diskutim në lidhje me destinimin e fitimit të vitit financiar 2023 të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k.

Në përputhje me nenin 9.8 të Statutit të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k., i ndryshuar më dt. 06.12.2021, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Referuar pasqyrave financiare vjetore për vitin financiar 2023, miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 20, dt. 18.04.2024, rezulton fitimi në vlerën 236,424,770 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë.
2. Pjesa e fitimit në vlerën 235,424,770 (dyqind e tridhjetë e pesë milion e katërqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë do të shpërndahet tek Ortakët e Shoqërisë, në përputhje me përqindjen respektive të pjesëmarrjes së secilit Ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, përkatësisht:
 - "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. – 78,474,923.333 (shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë treqind e tridhjetë e tre) lekë;
 - Z. Plarent Kristo – 78,474,923.333 (shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë treqind e tridhjetë e tre) lekë;
 - Z. Roland Joti - 78,474,923.333 (shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë treqind e tridhjetë e tre) lekë.

Për sa më sipër, plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 77 dhe 78 i Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe nga Statuti i Shoqërisë.

Kjo konfirmohet nga Certifikata e Aftësisë Paguese, e lëshuar nga Administratori i Shoqërisë, nën përgjegjësinë e tij të plotë.

Në përputhje me Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 58 "Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim", neni 29 "Përrjashtimi nga pjesëmarrja" dhe neni 59 "Norma e mbajtjes së tatimit në burim", Ortakut "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. nuk do t'i llogaritet tatimi në burim mbi dividendin, kurse dy Ortakëve të tjerë, Z. Plarent Kristo dhe Z. Roland Joti, do t'u llogaritet tatimi mbi dividendin në masën 8%.

3. Pjesa e fitimit në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë do të destinohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k., në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, sipas përqindjes respektive të pjesëmarrjes së secilit Ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, përkatësisht:

- "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k. – 333,333.333 (treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë treqind e tridhjetë e tre) lekë;
- Z. Plarent Kristo – 333,333.333 (treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë treqind e tridhjetë e tre) lekë;
- Z. Roland Joti – 333,333.333 (treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë treqind e tridhjetë e tre) lekë.

4. Në përfundim të procesit të zmadhimit të kapitalit, kapitali i regjistruar i shoqërisë "Inter Distribution Services" sh.p.k. do të bëhet 91,000,000 (nëntëdhjetë e një milion) lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota me vlerë nominale si më poshtë:

Nr.	Ortakët	Vlera e kapitalit para zmadhimit		Vlera e kapitalit pas zmadhimit	
		Vlera nominale (lekë)	Në %	Vlera nominale (lekë)	Në %
1.	"Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k.	30,000,000	33.333%	30,333,333.333	33.333%
2.	Z. Plarent Kristo	30,000,000	33.333%	30,333,333.333	33.333%
3.	Z. Roland Joti	30,000,000	33.333%	30,333,333.333	33.333%
	Total	90,000,000	100%	91,000,000	100%

5. Depozitim të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe organeve tatimore.

6. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, departamenti ligjor dhe departamenti i financës për ekzekutimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT



Plarent KRISTO

Roland JOTI

